



Hamdi Mramori Street, No 1
Prishtina 10000 – Kosovo
Tel: +381 (0) 38 247 615 ext. 103
Fax: +381 (0) 38 247 620
e-mail: info@ero-ks.org
www.ero-ks.org

Pristina, 13.09.2006

KOMENTET PRANUARA NGA KEK SH.A, KOSTT, TRIANGLE, Konsulentet NERA dhe KEMA, EGL

Këtu do të gjeni përmbledhjen e të gjitha komenteve dhe përgjegjet të pranuar deri me date 13.09.2006 nga Aplikuesit për Licencë dhe nga Konsulentët e NERA (finansuar nga AER dhe KEMA (finansuar nga Banka Botërore) të cilat I kemi pranuar në versionin e fundit të draft licencave. Të gjitha komentet janë marr në considerate.

Comments were received by:

- KEK sh.a. (Aplikues për Licencë për Gjenerim, Shpërndarje, Furnizim/Tregti dhe Furnizim Publik);
- KOSTT (Aplikues për Licencë për Operator të Sistemit të Transmisionit dhe Operator Tregu);
- Triangle (Aplikues për Licencë Gjenerimi)
- EGL (Aplikues për Licencë për Furnizim/Tregti) dhe
- Konsulentët KEMA dhe NERA

Komentet e KEK-ut në draft Licencën për Furnizim/ Tregti me enegji elektrike

KEK - Emertimi është Licencën për Furnizim /Tregti me energji elektrike
Propozojmë të jetë – **Licencë për Tregëti me enegji elektrike.**

ZRRE - Emërtimi i Licencës bazohet në Nenin 3.2 g) të Rregullit të Licencimit të Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë. Përpos licencës për furnizim/ tregti KEK-ut do ti lëshohet edhe Licenca për Furnizim Publik, gjërsa tregtarët/ furnitoret të tjerë nuk kanë të drejtë në licence per Furnizim Publik por vetem në licence furnizim/tregti.

Në seancës publike për mirratimin e Rregullit të Licencimit të Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë ne të gjithë së bashku (me përfaqësuesit e KEK-ut dhe te institucioneve të tjera) i kemi analizuar edhe këtë çështje dhe pas analizës Rregulli është mirratuar nga Bordi i ZRRE-së.

KEK- Pjesa I:Termt e licencës, pika 3.

Është Licenca lëshohet për blerjen e kapaciteteve të energjisë elektrike prej 100MW deri në 400MW. Propozojmë ‘**Licenca lëshohet për blerjen e kapaciteteve të energjisë elektrike deri në 400MW**’

ZRRE- Annexi A i Pasqyrës së Taksave, Rregull i mirratuar nga Bordi i ZRRE-së definon tri lloje të taksave varësisht prej kapaciteteve. Ju keni aplikuar për taksën në kategorinë A.2.2 , andaj ky koment nuk mund të pranohet për arsye të cekura më lartë.

A.2.1 nën 100 MW	€ 2000
A.2.2 tejkalon 100 MW por më e vogël se 400 MW	€ 3000
A.2.3 mbi 400 MW	€ 5000

KEK - Neni 2: Është - Llogaritë e ndara për Biznesin e Tregtisë, Furnizimit dhe Biznesin e Tregtisë Ndërkufitare. Propozojmë : **Llogaritë e ndara për Biznesin e Tregtisë dhe Biznesin e Tregtisë Ndërkufitare**

ZRRE - Ky koment ndërlidhet me dy komente të më parshme andaj për arsye se emertimi i licences ka mbetet i pandryshuar ky koment nuk mund të pranohet.

KEK - Neni 6: të sqarohet paragrafi 3 i këtij neni

ZRRE- Ky koment pranohet sepse përkthimi prej gjuhës angleze e ka ndryshuar kuptimin e dispozitës. Neni 6 pika 3 është ndryshuar si vijon:

“I Licencuari mund të shkarkohet nga detyrimet e paragrafit 1 duke dërguar informatën e nevojshme për secilin konsumator:

- a) në rastin kur konsumatorit fillon të furnizohet nga i Licencuari; dhe pas kësaj:
 - (i) kur faturat ose gjendjet në lidhje me ngarkesën e pagesës për furnizim të energjisë elektrike i janë dërguar konsumatorit, në baza tre mujore apo më shpesh (mjafton që informata të përfshihet në ndonjë faturë apo deklaratë); ose
 - (ii) në ndonjë rast tjetër, në bazë vjetore; dhe
- b) duke publikuar këtë informatë në mënyrë që të arrihet publiciteti adekuat.”

5. KEK - Neni 10: Kërkohet sqarim si do të realizojn tregtari këto obligime.

5. ZRRE- Pas analizës që e kemi kryer paraprakisht e në bazë të disa komenteve që janë marrë nga Furnitorët/Tregtarët të tjerë ne e kemi ndryshuar licencën edhe për KEK-un (por edhe për 3 furnitorët/ tregtar të tjerë që kanë aplikuar për licencë).

Neni 10.1 figuron në licence pasi kjo dispozitë bazohet në Nenin 30.2 a) dhe g) të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë ku kushtet për lëshimi e licencës janë a) siguria, g) mbrojtja e shëndetit të njerëzve dhe mjedisi. Sa i përket Nenit 10.2 dhe 10.3 që mund të shkaktoj shpenzime për angazhimin e një eksperti të pavarur dhe që mund të jenë të mëdha, ne e kemi pranuar këtë koment si arsyeshëm dhe licenca për furnizim / tregti tash përmban vetëm Nenin 10.1 gjersa 10.2 dhe 10.3 janë fshire.

KEK për Licencën për Furnizim Publik me energji elektrike

KEK- Pjesa I: Termat e licencës , Pika 4.nën a)

Është - shes, në baza ekskluzive, energji elektrike konsumatorëve jo të privilegjuar me çmim dhe tarifë të rregulluar, në përputhje me këtë licencë propozojmë: shes, në baza ekskluzive, energji elektrike konsumatorëve **tariforë** me çmim dhe tarifë të rregulluar, në përputhje me këtë licencë

ZRRE- Ky koment është pranuar kështu që përdoret rregulluar(tarifor)

KEK - pika 4: nën b) termi gjeneruesi të zëvendësohet me **prodhuesi**

ZRRE- Ky koment nuk është pranuar për arsye se përdorimi i shprehjes “prodhuesi” ose “gjeneruesi” nuk ndryshon esencën ose kuptimin e fjalisë.

KEK - Neni 7: të sqarohet pika 3 i këtij neni

ZRRE- Neni 7, pika 3 obligon të Licencuarin të veprojë në pajtueshmëri me urdhëresat apo vendimet e ZRRE-së të bëra sipas legjislacionit. Legjislacioni është definuar në Nenin 1 të Licences: **“Legjislacion”** nënkupton Ligjin mbi Energjinë (2004/8), Ligjin mbi Rregullatorin e Energjisë (2004/9), Ligjin mbi Energjinë Elektrike (2004/10) dhe çdo legjislacion tjetër parësor ose dytësor të nxjerrë për ekzekutimin e legjislacionit parësor që rregullon sektorin e energjisë.

Andaj i Licencuari (KEK-u) do të veprojë sipas urdhëresave ose vendimeve që i lëshon ZRRE-së në bazë të legjislacionit të përmendur më lartë.

KEK - Neni 17: pika 7 të harmonizohet në bazë të Rregullit mbi Kushtet e Përgjithëshme të furnizimit me energji elektrike.

ZRRE - Neni 17, pika 7 është bazuar në Nenin 57.5 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë. dhe nuk kundërshton dispozitat e Rregullit mbi Kushtet e Përgjithëshme të Furnizimit me Energji Elektrike.

KEK-ut për Licencat e Gjenerimit të energjisë elektrike për Kosovën A dhe për Kosovën B

KEK- Pjesa I:Termet e licencës - Aty ku është përdor fjala stacion propozojmë **Central**

ZRRE- Ky koment pranohet

KEK- Pika 5 a): të sqarohet

ZRRE- Pika 5 a) që ne verzionin e tanishem është 6a) tani lexon:

6. I Licencuari mund ta shes energjine elektrike qe e prodhon dhe kapacitet te centralit te tij elektrik me cmimet e negociuara lirshem:

- a) Konsumatoreve te privilegjuar lokal nepermes te kontratave duke u komunikuar sherbimet e tarifuara Operatorit te Sistemit te Transmissionit dhe Shperndarjes.....

KEK - pika 6 b): fjala energjetik të zëvendsohet me **Elektrik**

ZRRE- Ky koment pranohet

KEK - Faqe 9: Neni 7 : Fjala shpërndarje të zëvendsohet me **dispečing**

ZRRE – Pranohet

KEK - Faqe 10: Neni 9, Pika 3 : Fjala “kompetencës” të jetë pa thojza

ZRRE- Pranohet

Komentet e KEK-ut në draft Licencës për OSSH me kushte

KEK OSSH - Pjesa II KUSHTET E LICENCES, Neni 1 Përkufizimet dhe Interpretimet, alinea 10 ku thuhet “viti financiar” duhet që fjala financiar të zëvendsohet me fjalen afarist (viti afarist).

ZRRE- Në të gjitha aktet e nxjerrura nga ZRRE është përdorur termi “viti financiar” e ne verzionin anglisht perdoret shprehja “financial year” që është përkthimi adekuat i shprehjes.

KEK OSSH, Neni 4 – kushti 2 , duhet të precizohet , pas konsultimit me të licencuarin (**OSSH**)

ZRRE – Ky koment nuk eshte pranuar pasi qe Neni i cekur me larte potencon se konsultimet behen me te Licencuarin (shprehja qe perdoret ne cdo nen te Licences te OSSH) dhe pasi OSSH- ja eshet definuar si i Licencuari nuk ka nevojte te ipet edhe emri OSSH ne kete Nen.

KEK OSSH - Neni 11 alinea 1, afati gjasht (6) muaj të zgjatet në afat dymbëdhjet (12) muaj.

ZRRE - Pranohet: Është zgjatur afati nga 6 në 12 muaj.

KEK OSSH Neni 12 alinea 1, afati gjasht (6) muaj të zgjatet në afat dymbëdhjet (12) muaj.

ZRRE Pranohet: Është zgjatur afati nga 6 në 12 muaj.

KEK OSSH - Neni 13 alinea 2, afati gjasht (6) muaj të zgjatet në afat dymbëdhjet (12) muaj.

ZRRE- Ky koment nuk pranohet për arsye se ZRRE-ja ka punuar shumë me KEK-un rreth standardeve minimale për implementimin e Shpërndarjes dhe materialin nga prezentimet e zyrtarëve të ZRRE-së mund ta përdorni dhe ta finalizoni. Andaj konsiderojme se afati 6 muaj është i mjaftueshëm.

KEK OSSH - Neni 27 alinea 4, vlera prej 15% të bruto të ardhurave e të Licencuarit nga veprimtaria e ushtruar për vitin afarist paraprak, është shumë e lart dhe mendojmë që duhet zbritur në vlerë prej 5% të bruto të ardhurave e të Licencuarit nga veprimtaria e ushtruar për një muaj (për muajin paraprak).

ZRRE- Ky koment nuk mund të pranohet për arsye se bazohet në Nenin 57.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë

KEK OSSH Neni 27 alinea 5, vlera prej 300% e pages mujore, të zbritet në vlerë prej 30% të pages mujore

ZRRE- Ky koment nuk mund të pranohet për arsye se bazohet në Nenin 57.3 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë

Komentet nga Tregtari EGL-ja rreth Licencës për Furnizim/Tregti

EGL në Nenin 7 të draft Licencës: **Standardet për Përmbushje të plotë dhe Minimale për biznese të **Furnizimit/Tregtimit** – çka pritet më saktësisht nga Kompania jonë sipas kësaj dispozite?**

ZRRE: Përgjigjja në këtë pyetje ose në pyetjet e ngjashme mund të gjendet në Rregullin për Licencimin të Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, e cila është miratuar në seancë publike nga Bordi i ZRRE-së dhe është i aplikueshëm në Kosovë. Rregulli mund të shkarkohet nga faqja elektronike zyrtare e ZRRE-së: www.ero-ks.org (në “secondary legislation”) ku do të gjeni gjithashtu Rregulla të ndryshme të miratuara nga ZRRE-ja dhe që janë të aplikueshme në Kosovë.

Në përputhje me Nenin 29.2 e) dhe f) të Rregullës për Licencim të Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë me kërkesë të ZRRE-së, i licencuari do të dorëzoi si në vazhdim:

.....

e) informata për standardet e përmbushjes së shërbimeve të ofruara konsumatorëve duke përfshirë kualitetin e shërbimeve dhe sigurinë dhe qëndrueshmërinë e furnizimit;

f) treguesit që matin kontinuitetin e furnizimit (kohëzgjatjen, shpeshtësinë, numrin e ndërprerjeve dhe minutat e humbur për konsumatorë) dhe shërbimet e sistemit (kyçjen e

konsumatorëve të rinj me kohë, rregullimin e rënieve të sistemit, respektimin e kohës së marrëveshjeve për leximin e njehësorve, informatat e përgjithshme për njehsorëve);
h) informatat e tjera që ZRRE-ja mund ti kërkoj në lidhje me aktivitetet e licencuara.

Neni 24.5 I Rregullës për Licencim të Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë gjithashtu ju përgjigjet këtyre pyetjeve.

Brenda gjashtë (6) muajve pasi që t’ju është lëshuar licenca, i Licencuari do të përgatisë dhe dorëzoj në ZRRE për aprovim të saj një propozim për standardet e përmbushjes së aktiviteteve të tregtimit i cili do të përmbajë elementet që janë të vendosura në Nenin 7 .2. të Licencës. Kur ZRRE-ja të aprovoj standardet e përmbushjes së furnizimit/tregtimit të propozuara nga ju atëherë ZRRE-ja do të monitoroj përmbushjen e tyre.

EGL në lidhje me Nenin 8- Procedurat për zbulimin dhe parandalimin e vjedhjes, dëmtimit dhe ndërhyrjes në njehsor:

Neni 8.1. “sa I përket biznesit të tij për Furnizim/Tregtim i Licencuari do të ndërmarr të gjithë hapat që janë të arsyeshëm për të zbuluar dhe parandaluar:

- a) **vjedhjen** e energjisë elektrike në objektet që furnizohen nga ai;

EGL- A mund të influencohet?

ZRRE- Në rast të kryerjes të vetëm aktiviteteve të tregtimit kjo fjali nuk aplikohet. Por përderisa është përdorur forma e njëjtë e licencës edhe për bizneset e furnizimit në kemi vendosur që të lëmë këtë dispozitë si të përgjithshme në të gjitha format e licencave për furnizim/tregtim edhe përkundër faktit që në praktikë në rast të tregtarëve kjo nuk aplikohet. Ne gjithashtu mundemi dhe ta fshimë por në realitet nuk përbën ndonjë efekt në rast të bizneseve të tregtimit pasi që kompania juaj nuk mund të raportoj për një aktivitet që nuk mund ta shoh ose të jetë e njoftuar.

EGL Neni 10- Shëndeti dhe Siguria: Kjo dispozitë duket se kërkon nga EGL informata të pazakonta dhe disproporcionale.

“10.1. I licencuari do të marr të gjithë hapat e arsyeshëm për të mbrojtur personat dhe pronën nga lëndimi dhe dëmtimet që mund të shkaktohen nga ai gjatë kryerjes së aktiviteteve të licencuara.

10.2. I Licencuari do të siguroj që një ekspert i pavarur, emërimi i të cilit do të aprovoj nga ZRRE-ja, të kryej **në baza vjetore** auditim të gjendjes teknike dhe gjendjes së sigurisë të sistemit të furnizimit.

10.3. I Licencuari do ti japë ZRRE-së rezultatet e një auditimi të tillë Brenda tre (3) muajve pasi të jetë kryer ose prej momentit që e kërkon ZRRE-ja. “

ZRRE: kjo dispozitë është bazuar në nenin 30.2 a) dhe g) të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë ku kriteret e përgjithshme për dhënien e çdo licence janë: a). parrezikshmëria, siguria, dhe kualiteti i sistemit të shërbimeve për furnizim me energji elektrike, ngrohje dhe të gazit natyror dhe bazuar në g) mbrojtja e shëndetit njerëzor, sigurisë dhe ambientit.

Por ne kemi parasysh që në rast të licencës për furnizim /tregtim nuk është relevante dhe për këtë arsye në licencën e juaj do ta lëmë një dispozitë e përgjithshme të përfshirë në Nenin 10.1 dhe do të fshijmë nenin 10.2 dhe 10.3. Ne do të veprojmë njëjtë dhe në rastet e Tregtarëve të tjerë dhe do ti njoftojmë edhe ata me këtë.

EGL në lidhje me Nenin 13- Dispozita për informim të ZRRE-së: “Prapë, një zgjerim shumë I madh I të drejtave për informim duhet të ipet këtu”:

“13.1. I Licencuari do të dorëzoi në ZRRE, në mënyrë dhe kohë që ZRRE-ja **mund** të kërkoj, informatat dhe raportet e tilla siç **mund** ti konsideroi ZRRE-ja të nevojshme duke pasur parasysh çdo Nen ose kusht të kësaj licence ose për qëllim të përmbushjes së funksioneve të dhëna ose të transferuara sipas Nenit 29 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë ose **Legjislacioni** tjetër të aplikueshëm në Kosovë.”

ZRRE: “*Legjislacion*” është definuar si “Ligji për Energji (2004/8), Ligji për Rregullatorin e Energjisë (2004/9), Ligji për Energji Elektrike (2004/10) dhe legjislacionet tjera primare, ose sekondare të lëshuara gjatë ekzekutimit të legjislacionit primar që e rregullon sektorin e energjisë”; Ky legjislacion është i aplikueshëm në sektorin e energjisë në Kosovë në çdo rast dhe nuk ka asnjë mundësi të mënjanohet ndonjë obligim që është i përfshirë në ndonjë nga legjislacionet e përmendura më lartë. Neni 29 (I përmendur në këtë artikull thotë “ZRRE mund të kërkoj...” informata prandaj natyrisht që ZRRE-ja do të kërkoj informata në lidhje me bizneset e juaja. Por me qëllim që të jemi më specifik ne në vend të referimit në nenin 29 përfshijmë referimin në nenin 29.1. Por kërkesa e përgjithshme e mbledhjes së të dhënave duhet të mbes në licencën e juaj pasi që është e ndërlidhur me nenin 13 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë: ”13.1. Zyra e Rregullatorit për Energji do të ketë të drejtë të kërkoj nga çdo ndërmarrje e energjisë ose autoritet publik informata, të dhëna, dhe dokumente, duke përfshirë informata konfidenciale, që janë të nevojshme për përmbushjen e aktiviteteve, detyrave dhe kompetencave të saj.”

TRIANGL-i -KOMENTET për draft LICENCEN e GJENERIMIT

TRIANGL: Kërkojmë që në licencë tonë HIDROCENTRALI të MOS emërtohet si KOZHNJER por HIDROCENTRALI LUMBARDH pasi që edhe me pëlqimin e KEK – ut si prodhues të pavarur që nga fillimi i operimit komercial e kemi ndërruar këtë emërtim.

ZRRE- Sa i përket komentit të parë ne do ta përdorim emrin Lumbardhë dhe Kozhnjer por ju duhet edhe zyrtarisht të ndryshoni këtë emër në Librat e Regjistrimit të Biznesit. Kjo për arsye se nuk ka asnjë dëshmi në PPA ose Kontratë mbi Qeran që dëshmon për ndryshimin e emrit prej Kozhner në Lumbardhë përpos në Lejen e Ujit të lëshuar nga MMPH.

TRIANGL: Kërkojmë që tek neni 2 ku flitet për çështjen e kontabilitetit, në përputhje me ligjet e aplikueshme në Kosovë për kontabilitetin, në mënyrë të qartë dhe specifike të potenconi se KONTABILITETI I CILI DO TË PËRDORET ËSHTË KONTABILITETI SIPAS STANDARDEVE NDËRKOMBËTRA E I CILI ËSHTË NË FUQI ME LIGJE TË APLIKUESHME NË KOSOVË . Konsiderojmë se në Kosovë nuk ka mundësi që të përdorën dy mënyra dhe standarde të dyfishta të kontabilitetit.

ZRRE- Sa I përket komentit të dytë – atë e kemi miratuar dhe në Nenin 2 para.1 kemi shtuar fjalinë “ bazuar në standardet internacionale të inkuorporuar në legjislacionin që aplikohet në Kosovë”

Triangl: Ju njoftojmë se në bazë të kontratës për qiramarrjen që kemi me KEK është e përcaktuar se data e operimit komercial është data kur do të fillojnë detyrimet e ndërsjella në mes të palëve kontraktuese. Duke u nisur nga ky fakt Ju njoftojmë se data e fillimit të operimit komercial ka filluar me 01.10.2006 andaj në PJESËN 1 – termat e licencës neni 8 si datë e vlefshmërisë së licencës të jetë data 01.10.2024

ZRRE - Komenti nuk mund të pranohet sepse nuk kemi dëshmi se veprimi komercial I HC ka filluar me 1.10 2004. Nëse keni prova të duhura na i dërgoni e ne do të zgjasim licencën për 5 muaj, deri me 1.10 2024. (Deri në momentin kur këto komente janë përmbledh në nuk e kemi marrë asnjë provë për këtë. Andaj kohëzgjatja e licencës mbetet e njëjtte.

Me datën 13 Shtator KOSTT na ka dërguar komentet të reja për Licencën e OST dhe OT. Këto do të përfshihen në dokumentin tjetër.

Komentet e firmave konsulente KEMA dhe NERA

Draft Licenca e Operatorit të Tregut

Neni 1, Përkufizimi i Rregullave të Tregut. Licenca tashmë i referohet Rregullave të Përkohshme të Tregut (për shembull në Nenin 2.1. a), por vetëm “Rregullat e Tregut” është përcaktuar realisht. Për sqarim, mbase do ishte e dëshirueshme të zgjerohet përkufizimi i Rregullave të Tregut për të përfshirë rregullat e përkohshëm të tregut në çfarëdolloj forme. Çështja e rregullave të përkohshme të tregut është ngritur nga KEMA dhe është lëndë e një shënimi të veçantë.

Neni 3: paragrafi 5 më parë mbaronte me frazën “*për qëllimet e këtij Neni*”, por tani është fshirë. Kjo fshirje e bën paragrafin plotësisht të përgjithshëm, duke i dhënë ZRRE-së të drejta të pakufizuara për të nxjerrë udhëzime, andaj sugjerojmë që kjo frazë të shtohet sërish. Kjo pikë aplikohet edhe në licencat e tjera.

Neni 7, Kushti 2: ky i referohet OST-së dhe OSSH-së që kanë nënshkruar Marrëveshjen Kornizë, por unë besoj se kjo duhet të flasë edhe për prodhuesit dhe furnizuesit.

Neni 19: ky kusht tani është zgjeruar për t'iu referuar Strukturës Kapitale si dhe kontrollit. Edhe pse qëllimi i përgjithshëm është i qartë, janë vështirësitë që (i) termi “struktura kapitale” nuk është përkufizuar, dhe (ii) madje edhe një ndryshim shumë i vogël në strukturën kapitale (p.sh. një ndryshim i vogël në nivelin e huamarrjeve bankare?) do të kishte nevojë për të marrë lejen e ZRRE-së. Ka disa opsione të mundshme për të adresuar këtë: (i) referencat ndaj strukturës kapitale mund të fshihen plotësisht, (ii) mund të përcaktohet struktura kapitale (iii) mund të jepen disa kualifikime ndaj nevojës së ZRRE-së për aprovim, për shembull duke përcaktuar ndryshimet në strukturën kapitale që ka nevojë për leje, ose mbase duke shtuar “dhe ky aprovim nuk do të refuzohet pa arsye”. Edhe KEMA e ka ngritur këtë çështje, dhe unë besoj se ka gjasa që të dy opsionet t’u duken të pranueshëm.

Një çështje tjetër e ngritur nga KEMA është si vijon. Asnjë nuk është e pavarur ndaj kam propozuar ndryshime me vend aty ku duhet:

1. Neni 1, përkufizimi i “**anëtar**“(ortak) propozojnë që të ndryshohej paksa rreshti i parë, me si vijon: “**anëtar**“ortak” është, në marrëdhënie direkte ose indirekte me të licencuarin, çdo kompani aksionare kjo do të aplikohet në të gjithë licencat e tjera.
2. **Neni 2:** paragrafi 1, ata theksojnë se kjo i referohet Nenit 27.3 të Ligjit mbi Energjinë Elektrike, por se artikujt e renditur (a) deri në (j) nuk korrespondojnë me atë që thotë ky nen në këtë ligj. Renditja duket e përshtatshme ndaj, unë do të sugjeroja që thjesht të fshinim referencën me nenin 27.3.
3. **Neni 9,** paragrafi 1: vetë Rregullat e Tregut specifikojnë se pajisjet e IT dhe softueri i nevojshëm, dhe për të shmangur çdo konflikt, ata propozojnë që ose kjo të fshihet, ose që të shtohet referenca “në përputhje me Rregullat e Tregut”. Unë besoj se të dyja zgjidhjet mund të jenë të pranueshme.
4. **Neni 9,** paragrafi 4: vetë Rregullat e Tregut specifikojnë se cilave palë u lejohet qasja në disa të dhëna, dhe se ky paragraf është në konflikt potencial me to. Propozohet që ky paragraf të fshihet, gjë që mua më duket në rregull.
5. **Neni 10,** paragrafi 1: vetë Rregullat e Tregut specifikojnë këtë regjistër, dhe për të shmangur ndonjë konflikt, ata propozojnë që ose të fshihet paragrafi ose të shtohet një referencë “në përputhje me Rregullat e Tregut”. Të dyja zgjidhjet duken të pranueshme.
6. **Neni 11,** paragrafi 1: vetë Rregullat e Tregut garantojnë për këtë regjistër, dhe për të shmangur ndonjë konflikt, ata propozojnë që ose të fshihet paragrafi ose të shtohet një referencë “në përputhje me Rregullat e Tregut”. Të dyja zgjidhjet duken të pranueshme.
7. **Neni 12:** i gjithë neni mund të fshihet, pasi ata thonë se vetë rregullat e tregut e mbulojnë gjithë këtë, kështu që Neni nuk ka ndonjë qëllim real dhe mund të shkaktojë konflikt. Mua më duket se fshirja është e pranueshme, por duhet të kontrollohet prej ekspertëve të Rregullave të Tregut brenda në ZRRE.

8. **Neni 16**, vetë Rregullat e Tregut garantojnë për formatin e faturave dhe kjo është e panevojshme pra. Ata propozojnë që ose të fshihet paragrafi ose të shtohet një referencë “në përputhje me Rregullat e Tregut”. Mua më duket se fshirja është e pranueshme, por duhet të kontrollohet prej ekspertëve të Rregullave të Tregut brenda ne ZRRE.
9. **Neni 21**, paragrafi 1(b): kjo synon të nënkuptojë që i licencuari mund të kërkojë që licenca e vet të anulohet, por KEMA e ka interpretuar që të nënkuptojë se i licencuari mund të kërkojë që të anulohet licenca e një të licencuari *tjetër*. Për të shmangur dyshimet, unë sugjeroj që të ndryshohet në: ***b) një kërkesë që merret nga ndërmarrja energjetike e licencuar në lidhje me licencën e vet.***

Draft Licenca e Operatorit të Sistemit të Transmisionit

Përkufizimi i “**anëtar**“(ortak) e njëjta pikë si më sipër

Përkufizimi i Rregullave të Tregut: Kjo është njëjta pikë si për atë që u bë për licencën e OT. Ky përkufizim mund të ndryshohet që të përfshijë çdo rregull të përkohshëm të tregut brenda përkufizimit, në mënyrë që kudo që të ketë referenca ndaj rregullave të tregut, (në veçanti Neni 21), të mbulohen të gjithë mundësitë.

Neni 2, paragrafi 6: Kjo është pikë e ngjashme si për atë që u ngrit për OT, dhe është propozuar që në fund të paragrafit, të shtohet fraza “*për qëllimet e këtij Neni*”.

Neni 5, paragrafi 4: ka disa gabime shkrimi ndaj rreshti i dytë “the” duhet zëvendësuar me “to”, dhe në rreshtin e tretë duhet fshirë “to” e parë.

Neni 9: disa fjalë janë lënë jashtë në paragrafin 1, dhe si pasojë “ata” në rreshtin e parë nuk i referohet më shfrytëzuesve të rrjetit dhe ka nevojë që të rifrazohet. Do të sugjeroja që të ndryshohej paragrafi 1 në:

1. I Licencuari do të sigurojë që shfrytëzuesit aktualë dhe ata potencialë të sistemit të transmisionit të kenë qasje të pa-diskriminuar në informacionin që iu nevojitet për qasjen efikase në sistem, në përputhje me Nenin 13.1 (f) të Ligjit mbi Energjinë Elektrike.

Neni 25: kjo është e njëjta pikë për Strukturën Kapitale të ngritur më sipër. Edhe këtu duhet përdorur i njëjti opsion i përdorur gjatë.

Neni 28, paragrafi 1(b): kjo është pikë e ngjashme si ajo e ngritur më sipër, ndaj unë sugjeroj që të ndryshohet në: ***b) një kërkesë që merret nga ndërmarrja energjetike e licencuar në lidhje me licencën e vet.***

Pika të tjera: ZRRE ka kërkuar nëse janë nevojitur dispozita shtesë në lidhje me çmimet për të inkurajuar konkurrencën. Dispozitat e detajuara për tarifatat sigurisht nuk janë në licencë, dhe pjesa I përmban dispozita për inkurajimin e konkurrencës, dhe Neni 5 dispozita të përgjithshme mbi çmim-vënien. Por pasi e kemi shqyrtuar, unë mendoj se mbase dispozitat e përgjithshme të Nenit 5 mbi kushtet për kyçjen dhe shfrytëzimin e

sistemit duhet përforcuar. Prandaj, unë do të sugjeroja që të ndryshohet paragrafi i ri 5 në Nenin 5 ku lexon:

- 5.5. në vendosjen e tarifave dhe pagesave për kyçjen në, dhe shfrytëzimin e sistemit të transmisionit, i Licencuari duhet të japë sinjalet e duhura dhe jo diskriminuese të çmimeve dhe të sigurojë se këto tarifa dhe pagesa:
- inkurajojnë konkurrencën në sektorin energjetik dhe lehtësojnë hyrësit e rinj në treg; dhe
 - janë në përputhje me Metodologjinë e tarifave e aprovuar nga ZRRE-ja.

Draft Licenca e Furnizimit Publik

Përkufizimi i “**anëtar**“(ortak) e njëjta pikë si më sipër.

Përkufizimi i Rregullave të Tregut: E njëjta pikë për përfshirjen e rregullave të përkohshëm të tregut brenda që u bë më herët.

Neni 2, paragrafi 5: Kjo është pikë e ngjashme si për atë që u ngrit për OT, dhe është propozuar që në fund të paragrafit, të shtohet fraza “*për qëllimet e këtij Neni*”.

Neni 3: ka një gabim të vogël në perifrazimin ekzistues, dhe “njëri-tjetrin ose” duhet fshirë nga rreshti i tretë. Përveç kësaj, sugjeroj që të shtohet një dispozitë në lidhje me ndër-subvencionet midis konsumatorëve të privilegjuar dhe atyre jo të privilegjuar. Bazuar në këtë, unë propozoj tekstin vijues për Nenin:

- I Licencuari do të sigurojë që biznesi i furnizimit publik nuk jep ndonjë subvencion ose ndër-subvencion (direkt ose indirekt) ndaj, dhe as nuk merr ndonjë subvencion ose ndër-subvencion (direkt ose indirekt) prej, ndonjë biznesi tjetër të të Licencuarit dhe/ose ndonjë Ortaku ose ndërmarrjeje të lidhur me të Licencuarin dhe/ose ndonjë person tjetër.
- I Licencuari do të sigurojë që nuk lejon asnjë ndër-subvencion (direkt ose indirekt) midis konsumatorëve të privilegjuar dhe atyre jo të privilegjuar, e as ndërmjet ndonjë prej konsumatorëve të tjerë ose klasave të konsumatorëve të vet.

Neni 13: kjo është e njëjta pikë për Strukturën Kapitale të ngritur më sipër. Edhe këtu duhet përdorur i njëjti opsion i përdorur gjatë.

Neni 15: te paragrafi 6 termi Tregtia Ndërkufitare duhet me shkronja të mëdha pasi tani është një term i përcaktuar.

Neni 16, paragrafi 1(b): kjo është pikë e ngjashme si ajo e ngritur më sipër, ndaj unë sugjeroj që të ndryshohet në: **b) një kërkesë që merret nga ndërmarrja e energjisë e licencuar në lidhje me licencën e vet.**

Draft Licenca e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes

Përkufizimi i “**anëtar**“(ortak) e njëjta pikë si më sipër.

Përkufizimi i Rregullave të Tregut: E njëjta pikë për përfshirjen e rregullave të përkohshëm të tregut brenda që u bë më herët.

Neni 2, paragrafi 6: Kjo është pikë e ngjashme si për atë që u ngrit për OT, dhe është propozuar që në fund të paragrafit, të shtohet fraza “*për qëllimet e këtij Neni*”.

Neni 23: kjo është e njëjta pikë për Strukturën Kapitale të ngritur më sipër. Edhe këtu duhet përdorur i njëjti opsion i përdorur gjatë.

Neni 26, paragrafi 1(b): kjo është pikë e ngjashme si ajo e ngritur më sipër, ndaj unë sugjeroj që të ndryshohet në: *b) një kërkesë që merret nga ndërmarrja e energjisë e licencuar në lidhje me licencën e vet.*

Draft Licenca për Furnizimin me Energji Elektrike/Tregtim

Përkufizimi i “**anëtar**“(ortak) e njëjta pikë si më sipër.

Përkufizimi i **Rregullave të Tregut**: E njëjta pikë për përfshirjen e rregullave të përkohshëm të tregut brenda që u bë më herët.

Neni 3: termi Tregtia Ndërkufitare duhet me shkronja të mëdha pasi tani është një term i përcaktuar.

Neni 12: kjo është e njëjta pikë për Strukturën Kapitale të ngritur më sipër. Edhe këtu duhet përdorur i njëjti opsion i përdorur gjatë.

1. **Neni 14**, paragrafi 1(b): kjo është pikë e ngjashme si ajo e ngritur më sipër, ndaj unë sugjeroj që të ndryshohet në: *b) një kërkesë që merret nga ndërmarrja energjetike e licencuar në lidhje me licencën e vet.*

Draft Licenca për Gjenerim (për Kosovën A edhe për Kosovën B)

Përkufizimi i “**anëtar**“(ortak) e njëjta pikë si më sipër.

Përkufizimi i Rregullave të Tregut: E njëjta pikë për përfshirjen e rregullave të përkohshëm të tregut brenda që u bë më herët.

Neni 2, paragrafi 5: Kjo është pikë e ngjashme si për atë që u ngrit për OT, dhe është propozuar që në fund të paragrafit, të shtohet fraza “*për qëllimet e këtij Neni*”.

Neni 16: kjo është e njëjta pikë për Strukturën Kapitale të ngritur më sipër. Edhe këtu duhet përdorur i njëjti opsion i përdorur gjatë.

Neni 19, paragrafi 1(b): kjo është pikë e ngjashme si ajo e ngritur më sipër, ndaj unë sugjeroj që të ndryshohet në: *b) një kërkesë që merret nga ndërmarrja energjetike e licencuar në lidhje me licencën e vet.*

Neni 20: ka një pikë të përgjithshme që tashmë e kemi diskutuar për atë që a duhet të bazohen taksat në kapacitetin nominal apo në atë operacional, por unë besoj se kjo çështje është pothuajse e zgjidhur.

Komente për licencat te ngrohjes qendrore nuk ka pas.